



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
MISIONI NË KOSOVË

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisë
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

DEPARTAMENTI I DEMOKRATIZIMIT

Tryezë e rrumbullakët në nivel rajonal mbi shkollimin e Romëve, Ashkalive dhe Egjiptasve (RAE) në Kosovë

29 – 30 korrik 2003
OMIK HQ, Prishtinë

Përmbledhje

Në organizim të përbashkët të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Departamentit të Demokratizimit (DD) të OSBE-së, në selinë e OSBE-së, prej datës 29 deri me 30 korrik të vitit 2003, u mbajt një diskutim në nivelin rajonal lidhur me arsimimin e Romëve, Ashkalive dhe Egjiptasve (RAE).

Në këtë debat morrën pjesë afro 60 pjesëmarrës, përfshirë këtu përfaqësuesit e ministrisë, institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse (IPVQ-ve), ekspertët dhe aktivistët vendorë, deputetët e Kuvendit të Kosovës, ekspertët ndërkombëtarë të vendeve të Evropës Juglindore si dhe përfaqësuesit e OJQ-ve, të cilat merren me çështjet e arsimit .

Duke marrë parasysh sfidat dhe tundimet e ndryshme lidhur me shkollimin e RAE dhe nevojën urgjente për shqyrtimin publik të këtyre problemeve, diskutimi u përqëndrua në tri çështjekryesore:

- 1. Nivelin e ulët të regjistrimit të fëmijëve RAE në të gjithë sektorët e arsimit si dhe nivelin e lartë të braktisjes së shkollimit;*
- 2. Trajnimin e mësimdhënësve Romë, Ashkali and Egjiptas;*
- 3. Rikthimin e gjuhës rome si lëndë mësimore.*

Prezenca e faktorëve që janë drejtpërsëdrejti të përfshirë në procesin mësimor, prej nivelit më të ulët deri te niveli vendimmarrës, mundësoi dhe siguroi një forum mjaft të përshtatshëm për një debat të nivelit mjaft të lartë, dhe një shkëmbim të ekuilibruar të pikëpamjeve.

Nga kjo mbledhje dolën rekomandime praktike, të cilat do t'i shërbejnë ministrisë si pikënisje për hartimin e një strategjie zhvillimore për arsimimin e RAE, dhe njëherësh do të mundësojë edhe zhvillimin e një politike gjithëpërfshirëse për arsimimin e komuniteteve RAE .

1. Sfidat në arsimin e RAE	3
1.1 Të dhënat mbi regjistrimin	3
1.2 Fushat prioritare.....	4
2. Rekomandimet	4
2.1 Rekomandimet për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).....	4
2.1.1 Niveli i ulët i regjistrimit të fëmijëve RAE në të gjitha nivelet e arsimit dhe niveli i lartë i braktisjes së shkollimit	5
2.1.2 Trajnimi i mësimitdhënësve Romë, Ashkali and Egjiptas.....	6
2.1.3 Gjuha rome	6
2.2 Rekomandimet për OSBE-në	6
2.3 Rekomandimet për Romët, Ashkalinjët dhe Egjiptasit.....	7
2.4 Rekomandimet për OJQ-ët me seli në Kosovë.....	7
3. Shtojca A	8
4. Shtojca B	11

1. Sfidat në arsimin e komuniteteve RAE

Shoqëria mund të zhvillohet vetëm atëhere kur pjesëtarët e të gjitha komuniteteve kanë çasje të barabartë në shkollim dhe shërbime të tjera. Komunitetet e RAE në Kosovë¹ nuk mund ta mbajnë hapin me pjesëtarët e komuniteteve të tjera për shkak të një sërë arsyesh. Njëra nga arsyet pse kanë mbetur mbrapa me shkollimin e fëmijëve të tyre është se prindërit e komuniteteve të RAE nuk janë mjaft të vetëdijshëm për rëndësinë e shkollimit, si dhe për shkak të privilegjeve që i gëzojnë pjesëtarët e komuniteteve të tjera krahasuar me ato të komuniteteve të RAE. Ky është një problem i kahmotshëm jo vetëm në Kosovë, por edhe në të gjitha vendet e Evropës Lindore. Megjithatë, ngjarjet dhe zhvillimet pas vitit 1999 e kanë komplikuar, vështërsuar dhe përkeqësuar edhe më tepër pozitën edhe ashtu të rëndë të komuniteteve të RAE në Kosovë.

Sipas disa vlerësimeve jozytrate, popullata e RAE në Kosovë, pas konfliktit të vitit 1999, numëron 45,000 nga 100,000. Së këndejmi, edhe numri i nxënësve ka shënuar një rënie. Megjithëse, kanë kaluar katër vite pas konfliktit, kushtet e jetesës dhe situata e sigurisë për komunitetet nuk është ende e kënaqëshme. Prandaj, edhe përkundër përmirësimit gradual të situatës së sigurisë, prindërit e komuniteteve të RAE ende ngurrojnë që t'i dërgojnë fëmijët e tyre nëpër shkolla.

Veç kësaj, në arsimimin e komuniteteve të RAE ka pasë ndikim edhe situata e rëndë sociale dhe ekonomike. Kështu, shpeshherë për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike prindërit e RAE nuk mund t'i dërgojnë fëmijët e tyre nëpër shkolla. Për më tepër, edhe ata fëmijë të cilët i ndjekin mësimet nuk tregojnë rezultate të mira për shkak të barrierve dhe pengesave gjuhësore, apo edhe për shkak të diskriminimit të tyre. Për këtë arsye, kemi një nivel kaq të lartë të braktisjes së shkollimit nga ana e RAE.

1.1 Të dhënat mbi regjistrimin

Sipas të dhënave, të cilat i mblodhi Banka Botërore në prill të vitit 2002², numri i RAE që u regjistruan në shkollat e rregullta është 2,963 (Romë: 1,332, Ashkali: 1,192, Egjiptas: 439). Të dhënat mbi regjistrimin kanë përfshirë vetëm 6.5% të numrit të përgjithshëm të popullatës RAE, që momentalisht vlerësohet se është 45,000. Krahasuar me përqindjen e regjistrimit të nxënësve dhe studentëve shqiptarëve, që është 22% nga numri i përgjithshëm i popullatës shqiptare; përqindja e nxënësve dhe studentëve serb në Kosovë, në raport me numrin e popullatës, është përafërsisht 24%. Këto të dhëna tregojnë për një nivel shumë të ulët të regjistrimit të fëmijëve nga komunitetet e RAE.

Si pasojë e numrit të madh të atyre që e braktisin shkollimin, vetëm një numër i vogël i fëmijëve të RAE regjistrohen në shkolla të mesme (vetëm 168 nxënës) apo universitet (nga 10-të studentë në shkolla të larta pedagogjike dhe në universitet; ndërsa, deri më tani vetëm një prej tyre i ka regjistruar studimet pasdiplomike). Mungesa e mësimdhënësve RAE të kualifikuar - shumica prej tyre janë të papunë - ndikon në rënie e cilësisë së shkollimit të fëmijëve të RAE. Mësimdhënësit e komuniteteve tjera zakonisht nuk kanë njohuri të mjaftueshme mbi nevojat e veçanta të nxënësve RAE. Njëherësh, zakonet dhe traditat e vjetra, siç janë martesat e hershme, poashtu ndikojnë në shkallën e ulët të regjistrimit të tyre në shkolla, e sidomos të vajzave. Pjesëtarët e komunitetit RAE kanë ngritur vazhdimisht shqetësimet e tyre para përfaqësueseve të autoriteteve arsimore dhe bashkësisë ndërkombëtare. Kështu, sot ekzistojnë afro 1,600 fëmijë nga komunitetet e RAE, të cilët kanë dëshirë të shkollohen (shih më poshtë), dhe që me padurim presin reintegrimin e tyre në sistemin arsimor. Me përmirësimin e situatës së sigurisë, pjesëtarët e komuniteteve të RAE zunë të kthehen gjithnjë e më tepër në Kosovë. Sipas një raporti të Zyrës për Kthimin e të Zhvendosurve dhe Komuniteteve (ZKZHK), 46% nga numri i përgjithshëm i të kthyerve në vitin 2002, ishin pjesëtarë të komunitetit RAE.

¹ Dihet se Romët, Ashkalinjtë dhe Egjiptasit kanë prejardhje të ndryshme dhe së këndejmi, ata përballen edhe me probleme të ndryshme sa i takon arsimin, e sidomos kur është fjala për shkollimin e tyre në gjuhë amtare. Megjithatë, meqenëse këto komunitete ballafaqohen edhe me shumë probleme dhe sfida të ngjashme dhe mbase të njejta si fjala vjen, problemet e shkallës së ulët të regjistrimit, çasjes dhe mundësisë për shkollim dhe për të siguruar mësimdhënës të trajnuar, atëhere këtyre problemeve mund t'u çasemi edhe në një mënyrë të përbashkët. Debati u organizua për të trija këto komunitete, dhe për qëllime praktike, prej këtu e tutje do të përdoret shkurtesa "RAE".

²Burimi: World Bank/EMIS – Education Management Information System.

Organizatat joqeveritare (OJQ-ët) kanë filluar bashkëpunimin e tyre në këtë fushë të rëndësishme me shkollat vendore, qysh pas përfundimit të luftës. Për këtë arsye edhe filloi programi për mësim plotësues (një program për mësim të përsheptuar, që ka për qëllim t'u ndihmojë fëmijëve, të cilët kanë munguar në shkollë, për t'iu rikthyer procesit të rregullt mësimor) për nxënësit e komuniteteve RAE. Në verën e vitit 2002, UNMIK-u filloi për herë të parë zbatimin e këtij programi. Programi ishte përgatitur dhe menaxhuar në tërësi nga stafi i MASHT-it dhe është bashkëfinancuar nga OJQ-ja ndërkombëtare "Save the Children". Në program morrën pjesë afro 257 fëmijë RAE nga Peja, Gjakova dhe Shtimja. Prej tyre 248 e kaluan testin dhe shumica syresh janë të gatshëm për t'u integruar në procesin e rregullt mësimor në vitin akademik 2003/2004.

Sipas të dhënave të tanishme nga Sektori për Komunitete dhe Çështje Gjinore në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, janë identifikuar afro 1,600 fëmijë RAE për të marrë pjesë në këtë program. Për implementimin e këtij programi nevojiten afro 300,000 Euro, fond ky i cili do të duhet të sigurohet nga MASHT-i. Nëse ky program implementohet dhe krijohen kushtet për integrim, atëherë do të jetë e mundshme edhe rritja e nivelit të regjistrimit të fëmijëve RAE në shkolla, madje deri në 40% brenda dy vitesh.

1.2 Prioritetet

Në këtë debat, u identifikuan dhe u përcaktuan edhe prioritetet në të cilat duhet të fokusohen faktorët kryesorë.

- Promovimi i identitetit gjuhësor dhe kulturor i komuniteteve të RAE në kuadër të sistemit arsimor të Kosovës;
- Sigurimi i të drejtës së shkollimit për të gjithë fëmijët e RAE që garantohet me Ligjin mbi shkollimin fillor dhe të mesëm;
- Krijimi dhe zhvillimi i një sistemi arsimor, që i përgjigjet nevojave të veçanta sociale dhe ekonomike të komuniteteve të RAE;
- Hartimi i rregullores për programin e mësimin plotësues dhe përcaktimi i procedurave standarde për testim, vlerësim dhe lëshim të çertifikatave pas mësimin plotësues;
- Përgatitja e programit për trajnimin e mësimitdhënësve të RAE. Ky program duhet të drejtohet në bashkëpunim me KEDP (Projektin për Trajnimin e Mësimdhënësve të Kosovës);
- Në Nenin 3.2 (c) të Ligjit mbi shkollimin fillor dhe të mesëm, thuhet se komuniteteve u garantohet e drejta e tyre për shkollim në gjuhën amëtare. Prandaj, përfshirja e gjuhës, historisë dhe kulturës romë si lëndë të obligueshme për nxënësit romë – përpos lëndëve të tjera që mësohen në gjuhën e shumicës - do t'i ndihonte komunitetit Romë jo vetëm që ta ruaj identitetin e tij gjuhësor dhe kulturor, por edhe që të integrohet më shpejt në sistemin arsimor dhe në shoqërinë kosovare.

2. Rekomandimet

Nisur nga këto prioritetet, nga debati dolën një numër rekomandimesh për të gjithë akterët, përfshirë këtu MASHT-in, OSBE-në, OJQ-ët nga Kosova si dhe komunitetet e RAE. Më tutje në këtë tekst, po e japim një përvijim të rekomandimeve që dolën nga ky debat.

2.1 Rekomandimet për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është agjencioni më i rëndësishëm për zgjidhjen e problemeve me të cilat po përballlet arsimit i komuniteteve të RAE. Për zgjidhjen e problemeve të çasjes në shkollim të komuniteteve të RAE, MASHT-i duhet t'u përmbahet dhe t'i respektojë parimet dhe instrumentet rajonale dhe ndërkombëtare të të drejtave njerëzore³ mbi të drejtat e arsimimit të fëmijëve.

³ Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, Neni 2, Protokolli i parë; Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial, Nenet 2.2 dhe 5 (e) dhe (v); Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Neni 12.3 dhe 15; Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, neni 26 (ndalimin e shkeljes të secilës nga të drejtat e mbrojtura me ligj) dhe 27; Karata Evropiane për Gjuhët Rajonale dhe Evropiane, Neni 2 dhe 8 (Aneksi 3); UNESCO Konventa kundër Diskriminimit në Arsim, Neni 1, dhe 4 (c) (kjo e fundit re: kompensimi i mësimin); Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Neni 2, 13, dhe 14; Rekomandimet e Hagës mbi të Drejtat e Pakicave për

Standardi që aplikohet momentalisht në Kosovë është Rregullorja 2002/19 e UNMIK-ut Mbi promulgimin e Ligjit për shkollimin fillor dhe të mesëm, Neni 10.1 (a) dhe (b) dhe 17.1 (a) dhe (b), dhe 22.1.

Duke u nisur nga faktorët, të cilët ndikuan në gjendjen e pafavorshme të pjesëtarëve të komuniteteve të RAE në sistemin arsimor, MASHT-i duhet që të zhvillojë dhe implementojë politika që do të merren me të gjitha problemet dhe të cilat do të mundësojnë zgjidhjen e një morie problemesh të shkollimit të komuniteteve të RAE në përgjithësi. Për të përgatitur një startegji mbi politikën e shkollimit të nxënësve të RAE, autoritetet relevante inkurajohen dhe ftohen që të marrin parasysh rekomandimet që dolën nga tryeza e rumbullakët.

Në rekomandimet e poshtëshënuara, parashikohet një çasje më e koordinuar, e cila siguron mundësi të barabarta për komunitetet e RAE në sistemin arsimor dhe njëherësh, edhe njohjen e të drejtës për shkollim në gjuhët e tyre amtare. Këto janë ato veprime të planifikuara për të cilat OSBE-ja dhe MASHT-i dëshirojnë që të arrijnë një marrëveshje, për implementimin e tyre brenda një afati të shkurtër kohor.

MASHT-i duhet të:

- Sigurojë fonde për programin e mësimit plotësues për 1,600 nxënës të RAE në 12 komuna. Njëherësh, duhet shtuar angazhimet dhe përpjekjet për të mundësuar që programi për mësimit plotësues të fillojë në tetor të vitit 2003, dhe atë përnjëherë në të 12-të komunat.
- Lëshojë një Udhëzim Administrativ për të standardizuar programin e mësimit plotësues për tërë Kosovën.
- Hartojë një strategji vepruese për arsimin e RAE, ku do të përfshihen ekspertët (vendor dhe ndërkombëtar) në përgatitjen e politikës arsimuese, planprogramit mësimor, dhe çështjeve të cilat merren me aspekte të rëndësishme të arsimit, si fjala vjen, shëndetësi, mirëqenie sociale, punë, shërbime publike, ambient, përmes bashkëpunimit më efikas me ministrinë dhe institucionet tjera.
- Formojë grupin punues që do të të përbëhet nga përfaqësuesit e OSBE-së dhe MASHT-it për të vlerësuar realizueshmërinë e projektit për përfshirjen e gjuhës romë si lëndë opcionale për nxënësit romë. Grupi punues duhet të hartojë një projekt të detajuar me afatet kohore dhe shpenzimet e projektit, i cili më pas, do t'i prezantohet donatorëve potencialë. Njëherësh, duhet kërkuar edhe ndihma profesionale dhe teknike nga institucionet rajonale dhe ndërkombëtare.
- Krijojë kushte të nevojshme për të siguruar çasje në shkollim dhe informata për të gjithë nxënësit, përfshirë këtu përmirësimin e çasjes në institucionet shkollore, përmes sigurimit të transportit për nxënësit e RAE.
- Përpiqet që të përfitojë nga përvojat më të mira të institucioneve nga rajoni, të cilat merren me çështjet e arsimit të RAE. Për këtë arsye, këto vizita në vendet e rajonit duhet të përgatiten sa më parë, në mënyrë që të mësojmë nga përvojat e këtyre vendeve.

2.1.1 Niveli i ulët i regjistrimit të fëmijëve RAE në të gjitha nivelet e arsimit dhe niveli i lartë i braktisjes së shkollimit

MASHT duhet të:

- Zhvillojë dhe implementojë një program mbi ngritjen e vetëdijes së prindërve të RAE- në nivelin kosovar- për rëndësinë e shkollimit, në pajtim me dispozitat e parapara me Rregulloren 2000/51 të UNMIK-ut.

- Organizojë dhe përfshijë plane dhe programe parashkollore për fëmijët e RAE si përcaktues vendimtar për regjistrimin dhe shkollimin e mëtejshëm në sistemin e rregullt arsimor.
- Zhvillojë dhe mbështesë programe për arsimim/ trajnim profesional të rinisë RAE.
- Përgatisë skema të bursave për komunitetet jo-shumicë, duke i kushtur me këtë rast rëndësi të veçantë sigurimit të bursave për nxënësit e RAE. Ky program duhet të implemetohet në bashkëpunim të ngushtë me Fondacionin Kosovar për Shoqëri Civile, i cili njëherësh është edhe menaxhues i bursave nga Agjencioni Evropian për Rindërtim për nxënësit e shkollave të mesme të RAE.
- Nxisë dhe detyrojë komunitetet që t'i përmbushin obligimet e tyre për të organizuar dhe siguruar transport të sigurt dhe efikas, sidomos për fëmijët e komuniteteve jo-shumicë, në pajtim me nenin 22.1 të Ligjit mbi shkollimin fillor dhe të mesëm.
- Shtojë angazhimin dhe përkushtimin e komuniteteve të RAE për shkollimin e fëmijëve RAE, përmes involvimit të OJQ-ve vendore apo ndihmësve të arsimtarëve romë.

2.1.2 Trajnimi i mësimdhënësve Romë, Ashkali dhe Egjiptas

MASHT duhet të:

- Përfshijë elementet e tolerancës, vlerave demokratike dhe aspekteve të të drejtave njerëzore në trajnimin e mësimdhënësve.
- Organizojë, tok me institucionet e përshtatshme dhe OJQ-ët- nëpër tërë Kosovën, skemën e ndihmës mësimdhënësve për trajnimin e mësimdhënësve RAE të papunë, por të kualifikuar, si dhe të organizojë seminare, mbi nevojat e veçanta të nxënësve RAE, për mësimdhënës që nuk vijnë nga komunitetet e RAE, por të cilët punojnë me nxënësit e RAE.

2.1.3 Gjuha rome

MASHT duhet të:

- Përfshijë gjuhën rome në planprogramin e Kosovës si lëndë opsionale për nxënësit romë.
- Themelojë një grup punues, në nivelin rajonal, për përgatitjen e mjeteve mësimore për mësimin në gjuhën rome dhe të lëndës dhe materialit për historinë, muzikën, kulturën dhe traditën rome.
- Përgatisë dhe implementojë programe për ndihmësit e mësimdhënësve romë, që të mundësojë përkrahjen e nxënësve romë për t'u shkolluar në nivelin shkollor. Ndihmësit e mësimdhënësve romë duhet punësuar me kohë të pacaktuar.

2.2 Rekomandimet për OSBE-në

OSBE-ja duhet të:

- Përcjellë dhe përkrahë rezultatet e MASHT-it në përgatitjen e strategjisë dhe krijimin e politikave, përmes përcaktimit të një zyreje për bashkëpunim me MASHT-in në mision.
- Punojë tok me MASHT-in për identifikimin e donatorëve potencialë për programet e shkollimit të RAE.

- Përkrahë shkëmbimet ndërkombëtare kulturore të ekspertizës, përmes udhëtimeve studimore, konferencave dhe krijimit të grupeve punuese.
- Mbështesë themelimin e grupeve/rrjeteve punuese të ekspertëve dhe aktivistëve RAE të arsimit, si bashkëpunëtorë profesional të MASHT-it.
- Informojë agjencitë financuese rreth nevojave financiare dhe kontributeve për projektet arsimuese të RAE.

2.3 Rekomandimet për komunitetet e Romëve, Ashkalive dhe Egjiptasve

Komunitetet Rome, Ashkali dhe Egjiptase duhet të:

- Interesohen, angazhohen dhe kontribuojnë më tepër për përmirësimin e situatës në fushën e arsimit të RAE.
- Përmirësojnë çasjen profesionale të OJQ-ve të RAE, të cilat janë në gjendje të implementojnë projekte mbi ngritjen e vetëdijes për arsimimim, në nivel vendor.
- Marrin më tepër përgjegjësi dhe të kontribojë e të ndihmojnë më shumë profesionalisht MASHT-in, duke krijuar një grup punues për të promovuar identitetin dhe interesat e komuniteteve.
- Krijojnë lidhje në mesin e mësimdhënësve RAE, për të punuar për të mirën dhe avansimit e çështjes së arsimit të të gjitha komuniteteve, dhe jo të pengojë zhvillimin duke theksuar dallimet.

2.4 Rekomandimet për OJQ-ët me seli në Kosovë

OJQ-ët me seli në Kosovë duhet të:

- Themelojnë një rrjetë të OJQ-ve, që punojnë në sektorin e arsimit të RAE, për të shkëmbyer informacione dhe për të kontribuar në zbatimin e startegjisë së përbashkët, nën drejtimin e MASHT-it.
- Prezantojnë dhe përkrahin- nevojat për përmirësimin e gjendjes në arsimin e RAE, në nivel ndërkombëtar.
- Informojnë agjencitë financuese për nevojat financiare dhe kontributet për projektet arsimuese të RAE.

3. Shtojca A

Rendi i ditës së tryezës së rrumbullakët

E martë, 29 korrik 2003

- 1030 – 1100 Regjistrimi i pjesëmarrësve
- 1100 – 1115 Fjala përshëndetëse
(Z.Adam Schmidt, Zv-Drejtor i Departamentit për Demokratizim pranë OmiK)
- 1115 – 1130 Fjala hyrëse
(Z.Isuf Zeneli, Sekretari i Përhershëm, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, MASHT)
- 1130 – 1140 Të drejtat e pakicave në arsim
(Z.Abdul Aziz Khan, Zyrtar Kryesor Ndërkombëtar, MASHT)
- 1140 – 1200 Gjendja e tanishme e arsimit të komuniteteve RAE në Kosovë – çështjet/të arriturat
(Z.Zafeer Ud Din, Këshilltar Ndërkombëtar, Sektori për Komunitete dhe Çështje Gjinore, MASHT)
- 1200 – 1330 Dreka në restaurantin e OSBE-së

Tema 1: Niveli i ulët i regjistrimit të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në të gjitha sektoret e arsimit si dhe shkalla e lartë e braktisjes

- 1330 – 1345 Pengesat në qasjen e barabartë në edukim për anëtarët e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptase në Kosovë: Një prespektivë e të drejtave të njeriut
(Z.Gregory Fabian, Këshilltar i Lartë Ligjor/Sektori për Mos-Diskriminim, Departamenti për Drejtat e Njeriut/Sundimi i Ligjit, OSBE)
- 1345 – 1415 Diskutim
- 1415 – 1420 Përmbyllje
- 1420 - 1435 Ngritja e vetëdijes për arsimim dhe motivimi i dobët për të mësuar
(Znj.Enesa Kadic, Udhëheqëse e Sektorit për Komunitete dhe Çështje Gjinore, MASHT)
- 1435 – 1505 Diskutim
- 1505 – 1510 Përmbyllje
- 1510 – 1530 Pushim
- 1530 – 1545 Integrimi i fëmijëve RAE në sistemin e rregullt arsimor të Kosovës

(Znj. Jadranka Huljev, Këshilltare për Arsimin e Pakicave, përfshirë popullatën Rome, Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Kroaci)

- 1545 - 1615 Diskutim
- 1615 – 1620 Përmbyllje
- 1620 – 1635 Integrimi dhe gjuha rome
(Znj. Suzana Zivkovic, Friends of the children, Kosova; Znj. Vladislava Milic, Caritas France, Kosova)
- 1635 – 1705 Diskutim
- 1705 – 1710 Përmbyllje
- 1710 – 1725 Vërejtjet përfundimtare për ditën e parë

E mërkurë, 30 korrik 2003

1030 – 1045 E drejta për arsim në gjuhën amtare – ligji mbi arsimin fillor dhe të mesëm
(Z. Xhavit Rexhaj, Drejtor, Departamenti i Arsimit, MASHT)

1045 – 1115 Diskutim

1115 – 1120 Përmbyllje

Tema 2: Trajnimi i Mësimdhënësve për Romë, Ashkali dhe Egjiptian

1120 – 1130 Break

1130 – 1145 Trajnimi i mësimdhënësve - nevoja, rëndësia dhe qëllimi
(Znj. Milica Kostadinovic, Projekti për Zhvillimin e Mësimdhënësve të Kosovës)

1145 – 1215 Diskutim

1215- 1220 Përmbyllje

1220 – 1235 Trajnimi mbi arsimimin multikulturor
(Znj. Jelena Vidmar, Trajnere e mësimdhënësve, Instituti për Hulumtime Arsimore, Qendra për Hulumtime Zhvillimore për Iniciativat Pedagogjike Hap pas Hapi, Sloveni)

1235 – 1305 Diskutim

1305 – 1310 Përmbyllje

1310 – 1430 Dreka në restaurantin e OSBE-së

1315 – 1345 Konferencë për Shtyp
*(Z. Sven Lindholm, Zëvendës i zëdhënësit, OSBE
Z. Gregory Fabian, Këshilltar i lartë ligjor
Znj. Juliane Markard, Zyrtare e programit në ekipin për perkrahjen e komuniteteve etnike
Z. Isuf Zeneli, Sekrtar i përhershëm, MASHT
Z. Abdul Aziz Khan, Zyrtar kryesor ndërkombëtar, MASHT)*

Tema 3: Gjuha rome

- 1430 – 1445 Paraqitja e gjuhës, historisë dhe kulturës rome në planprogramin Kosovar
(Z.Gheorghe Sarau, *Këshilltar për Arsimin Romë, Ministria e Arsimit, Rumani*)
- 1445 – 1515 Diskutim
- 1515 – 1520 Përmbyllje
- 1520 – 1535 Gjuha rome si lëndë shkollore – riintegrimi i gjuhës rome si lëndë shkollore
(Z.Kujtim Pacaku, *mësimdhënës i gjuhës rome, Kosova*)
- 1535 – 1605 Diskutim
- 1605 – 1610 Përmbyllje
- 1610 – 1630 Fjalët përmbyllëse për ditën e dytë dhe raporti përmbledhës të rekomandimeve për tryezën e rrumbullakët

4. Shtojca B

Lista e pjesëmarrësëve

<i>Emri dhe mbiemri</i>	<i>Institucioni/Profesioni/Vendi</i>
Osman Osmani	Mësues, Prizren
Kujtim Pacaku	Gazetarë, Prizren
Sami Cerimi	Mësues, Ferizaj/Uroševac
Shpresa Agushi	Fondacioni Kosovar për shoqëri civile
Becir Bytiqi	Mësues
Abdullah Qafani	Mjek
Ramadan Demiri	Mësues, Gjilan/Gnjilane
Florim Bajrami	Asistent i të drejtave të njeriut, Misioni i OSBE-së, Gjilan/Gnjilane
Islam Elshani	Zyra e vendit, punëtorë me raste
Ibrahim Elshani	Profesor, Prizren
Emsale Merxhollari	Centari Romane Djuvlenge, Prizren
Shemsije Xhaferi	Women help Women, Rahovec/Orahovac
Agim Hyseni	Shpresa demokratike, Podujevë/Podujevo
Daut Qylanxhi	Durmis Aslano, Prizren
Ramic Arif	Mësues, Çagllavicë/Caglavica
Bashkim Ibishi	Zyra e kthimit dhe e komuniteteve
Astrid Fetahu	Shoqata “Nëna Terezë”
Halil Qerimi	Aktivist shoqërorë
Mefail Mustafa	American Refugee Committee
Bajram Maroli	Avokatë shoqërorë
Bajrush Berisha	Mësues
Mirlinda Vraniqi	Zyra e vendit, asistent
Zylfi Mergja	PREBK
Faik Marolli	PDASHK
Xhevdet Neziraj	IRDK
Nafije Gas	Përfaqësues i “komuniteteve të tjera”
Hajredin Kuqi	Komisioni për arsim, shkencë dhe teknologji/ kryesues
Nimon Alimusaj	Komisioni për arsim, shkencë dhe teknologji / zëvendëskryesuesi i parë
Smilka Milisavljevic	Komisioni për arsim, shkencë dhe teknologji/ zëvendëskryesuesi i dytë
Isuf Zeneli	Sekretari permanent
Abdul Aziz Khan	Zyrtari kryesorë ndërkombëtarë
Johann Schrupf	Këshilltarë ndërkombëtarë, Departmenti i arsimit
Zafeer Ud Din	Këshilltarë ndërkombëtarë, Komunitetet dhe seksioni gjinorë
Marcella Osinde	Këshilltarë, Komunitetet dhe seksioni gjinorë
Enesa Kadiç	Kryesuese, Komunitetet dhe seksioni gjinorë
Gjyzel Shaljani	Asistent administrativ, Komunitetet dhe seksioni gjinorë
Esma Basholi	Asistent administrativ, Komunitetet dhe seksioni gjinorë
Xhavit Rexhaj	Kryesues , Departmenti i arsimit
Ramush Lekaj	Kryesues, Seksioni i kurikulit
Remzi Salihu	Shef i seksionit, Seksioni për trajnimin e mësuesëve
Ragip Zekolli	Kryesues, Arsimimi i përgjithshëm
Valerie Nizigama	Këshilltarë, Seksioni i arsimit
Fumiko Hakoyama	UNICEF
Dukagjin Popovci	Qendra arsimore e Kosoves
Nicolae Gheorghe	ODIHR, Person kontakti për çështjet e romëve dhe sintive
Petrit Sopjani/ Katherine Mahoney	Save the Children
Arbnor Pula	Forum for Democratic Initiative
Idriz Kutllovci	Drejtor i shollës, Pandeli Sotiri, Obilic/q

Rame Kryeziu	Shërbimi policor i Kosovës, Community Police
Bedri Xhafa	AGEF
Cardinal Uwishaka	OXFAM
Omer Dincsoy	Zyra për çështjet politike, Z/PSSP
Avni Sahiti	Education Project (EPIP), Banka Botërore